

Fëmija im shkruan numrat si të pasqyruar

A është normale që një fëmijë të shkruajë numrat përmbyss/ si të pasqyruar? Kjo varet nga mosha e tij.

“Jam baba i një djali 7-vjeçar që ka vështirësi në shkrimin e numrave që kur ka qenë në kopësht. Ai i njeh numrat në libra ose në lojëra, por disa numra si 3 ose 7 shkruhen shumë shpesh si të pasqyruar. Kam vënë re që djali im është mëngjarash dhe pyes veten nëse mund të ketë një lidhje. Them gjithashtu se ai mund të jetë i pavëmendshëm ose më pak i zellshëm sepse është djalë. A është normale kjo? C ‘farë të bëj për ta ndihmuar atë? “

Sistemi i numrave ka vetëm dhjetë simbole që janë 0 1 2 3 4 5 6 7 8 9. Atëherë mund të besohet se është shumë e thjeshtë për t'i njohur dhe shkruar. Njohja dhe shkrimi i numrave janë dy aktivitete të ndryshme. Të dyja kërkojnë që fëmija të jetë në gjendje të shikojë të gjithë elementët. Shkrimi i numrave kërkon gjithashtu aftësi manuale të rëndësishme për të zotëruar gjestin e të shkruarit. Prandaj, fëmijëve u duhet kohë dhe praktikë për të përvetësuar shkrimin e numrave në mënyrë automatike.

Pse fëmija im shkruan numra si të pasqyruar?

Shkrimi i numrave të pasqyruar nuk lidhet me gjininë e fëmijës, me dorën që përdor për të shkruar apo edhe me problemin e pavëmendjes. Djemtë, vajzat, djathtakët, mëngjarashët shkruajnë shifra si të pasqyruara sa njëra palë edhe tjetra. Fëmijët shkruajnë numra si të pasqyruar edhe kur ata janë shumë të vëmendshëm. Në fakt, shkrimi në pasqyrë i numrave është një fenomen i zakonshëm që vërehet tek fëmijët

deri në moshën 5-6 vjeç, që do të shpjegohej me faktin se fëmija zbaton një rregull shkrimi sipas orientimit të numrave. Disa numra shkruhen me një lak të hapur në të majtë (si 1, 2, 3, 7, 9) ndërsa disa të tjerë shkruhen me një lak të hapur në të djathtë (si 4, 5, 6).

Shifrat 0 dhe 8 nuk mund shkruhen si të pasqyruar. Nëse fëmija, shpesh ose gjithmonë, zbaton një rregull të shkrimit nga e djathta në të majtë, ai do të prodhojë numra si të pasqyruar atëherë kur këta duhet të shkruhen nga e majta në të djathtë, dhe anasjelltas.

Fëmija im është 3-4 vjeç, ai është në seksionin e Vogël ose të Mesëm të kopshtit.

Fëmija po zbulon numrat. Ai po mëson të njohë numrat. Shkrimi i numrave është ende shumë i vështirë. Është normale që, nëse fëmija është i interesuar të shkruajë numra, të prodhojë numra të palexueshëm ose numra të lexueshëm të shkruar si të pasqyruara. Nëse fëmija prodhon numra si të pasqyruar, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar. Mjafton të ri jepet modeli në mënyrë të natyrshme në komunikim, zbavitje dhe lojë.

Fëmija im është 5-6 vjeç, ai është në seksionin e Madh të Kopshtit

Fëmija po mëson numrat. Ai po mëson të shkruajë numrat dhe zotërimi është ende i vështirë. Në këtë moshë, është e zakonshme të vihen re numra të shkruar si të pasqyruar tek fëmijët pa vështirësi të veçanta dhe ato nuk do të sjellin vështirësi më

vonë. Rreth 20% e prodhimeve të fëmijëve 5-6 vjeç janë numra të shkruar si të pasqyruar nga e djathta në të majtë. Më shumë se 88% e fëmijëve të moshës 5-6 vjeçare prodhojnë të paktën një në gjashtëmbëdhjetë herë një shkrim si të pasqyruar. Numri 3 është numri që shkruhet më shpesh si i pasqyruar (deri në 60%). Pastaj vijnë numrat 9, 7, 1, 2, 5, 6, 4 (me pothuajse 10% për numrin 4). Nëse fëmija shkruan numra në formë të pasqyruar, rekomandohet të bisedohet me mësuesin: ky do të jetë në gjendje të thotë nëse proporcioni i numrave të shkruar si të pasqyruar është normal. Në këtë moshë, nuk ka asgjë për t'u shqetësuar shumë. Është e domosdoshme t'i jepet modeli në mënyrë të natyrshme në komunikim, zbavitje dhe lojë. Është e rëndësishme të ushtrohet shkrimi i numrave: ky mund të bëhet nëpërmjet lojërave të shkrimit në një fletë, mbi një pllakë, mbi një tabelë të madhe, por edhe në ajër pa mbështetje, pa ose me shoqërim gjesti. Mbyllni sytë, fëmija juaj ju mban dorën tuaj dhe ju bën të shkruani një numër në ajër, ju duhet të gjeni numrin. E kundërta është gjithashtu interesante për të dhënë një model.

Fëmija im është 6-7 vjeç, është në klasën e parë (CP)

Fëmija gradualisht automatizon të gjithë shkrimet e numrave. Shkrimet si të pasqyruara vihen re gjatë mësimave në klasën e parë por ato pothuajse zhduken në fund të vitit shkollor. Është vlerësuar se më pak se 5% e numrave të shkruar, shkruhen si të pasqyruara. Është normale që, ndonjëherë, fëmija heziton në shkrimin e numrave dhe bën akoma disa shkrime si të pasqyruar. Nëse ai nuk ka vështirësi të tjera në matematikë apo në nivelin motorik, nuk duhet të shqetësohemi.

Duhet të jemi vigjilentë për sa i përket zhvillimit gjatë muajve të ardhshëm në tremujorin e parë të klasës fillore 1 (CE1).

Fëmija im është mbi 8 vjeç, ai është në klasën fillore 1 (CE1) ose në një klasë më të lartë

Pas moshës 8 vjeçare, fëmija ka automatizuar të gjitha shkrimet e numrave. Të shkruarit si në pasqyrë është zhdukur pothuajse tërësisht. Nëse ndodhin akoma hezitimet dhe shkrimet si në pasqyrë, fëmija mund të ketë nevojë për ndihmë të specializuar për shkrimin e numrave. Nëse vështirësitë në të shkruar shoqërohen me vështirësi në matematikë, vështirësi të përgjithshme motorike ose grafike, dhe/ose vështirësi në shkrimin e shkronjave (shkrimi i shkronjave si të pasqyruara), fëmija mund të ketë nevojë për një bilanc për të folur (orthophonique).

Me pak fjalë, ç ‘duhet të mbaj mend:

Djemtë bëjnë numra si të pasqyruar po aq sa edhe vajzat.

Mëngjarashët prodhojnë po aq numra si të pasqyruar sa edhe djathtakët.

Shkrimi i numrave si të pasqyruar nuk lidhet me një problem mos vëmendje.

Shkrimi i numrave si të pasqyruar lidhet me moshën: në moshën 5-6 vjeç (kopsht) ndodh shpesh dhe është normale të shkruhen numrat si të pasqyruar. Sidoqoftë, që nga klasa e parë (CP), shkrimet si të pasqyruara zhduken gradualisht. Në CE1,

ndodh shumë rrallë të shkruhen numrat si te pasqyruar. Numri 3 është numri i shkruar më shpesh si i pasqyruar tek fëmijët e moshës 5-6 vjeç.